

PROCES-VERBAL

MBI ZHVILLIMIN E DËGJESËS PUBLIKE ME OBJEKT:

“VENDNDODHJA E STACIONIT TË TRANSFERIMIT TË MBETJEVE, NË PASURINË NR. 267, ME SIPËRFAQE 388.500M², Z.K 3756, VËRZHEZHË, FSHATI ORIZAJ, BASHKIA SKRAPAR”

Bashkia: SKRAPAR

Data: 09.06.2026

Ora: 18:00

Vendi: Salla e mbledhjeve, Bashkia Skrapar

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” dhe ligjit nr. 57/2025 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, më datë 09.06.2026, në ambientet e Bashkisë Skrapar u zhvillua dëgjesa publike lidhur me vendndodhjen e propozuar të “Stacionit të Transferimit të Mbetjeve të Ngurta”.

Dëgjesa publike u njoftua paraprakisht në përputhje me procedurat ligjore, me qëllim garantimin e pjesëmarrjes së publikut dhe marrjen e mendimeve të komunitetit.

Të pranishëm në dëgjese :

Anëtarë të Këshillit Bashkiak:

Përfaqësues të Bashkisë Skrapar;

Përfaqësues të institucioneve Vendore;

Përfaqësues të Njesisë Administrative Qendër;

Banorë të fshatrave Munushtir dhe Orizaj dhe banorë të qytetit të Çorovodës

Objektivi i dëgjesës

Qëllimi i dëgjesës ishte informimi i publikut mbi vendndodhjen e Stacionit të Transferimit të Mbetjeve të Ngurta në pasurinë me nr.267, me sipërfaqe 388.500 m², ZK 3756, Vërzhezhë, fshati Orizaj, Bashkia Skrapar si dhe dhënia e mendimeve, komenteve dhe sugjerimeve nga të gjithë aktorët e interesit.

Diskutimet

Takimi u hap nga Kryetari i Bashkisë Skrapar, Z. Adriatik Mema, i cili falënderoi pjesëmarrësit për praninë e tyre dhe theksoi rëndësinë e konsultimit publik në proceset e vendimmarrjes që lidhen me interesin e komunitetit.

Më pas, Z. Mema, prezantoi qëllimin e dëgjesës publike, duke sqaruar se objekti i konsultimit ishte vendndodhja e propozuar për Stacionin e Transferimit të Mbetjeve të Ngurta në pasurinë me nr.267, me sipërfaqe 388.500 m², ZK 3756, Vërzhezhë, fshati Orizaj, Bashkia Skrapar. Ai bëri me dije se përzgjedhja e kësaj vendndodhjeje është mbështetur në kritere teknike dhe funksionale, me qëllim përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve në territorin e Bashkisë Skrapar.

Më pas, fjalën e mori Nënkryetarja e Bashkisë Skrapar, Znj. Sonila Hysenbelliu, e cila informoi të pranishmit për fitimet e Bashkisë Skrapar, nga faza e parë e projektit, Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve, për Qarkun Berat dhe se aktualisht projekti ndodhet në fazën e dytë të tij.

Ajo sqaroi se nga faza e parë e projektit përveç investimeve specifike për secilën Bashki, u përfitua hartimi i Planeve Vendore të Menaxhimit të Mbetjeve për 5 bashkitë e qarkut, si dhe hartimi i Planit Rajonal të Menaxhimit të Mbetjeve për Qarkun Berat.

Sipas saj, në Planin Vendor të Bashkisë Skrapar është parashikuar si objektiv kryesor transformimi i vend depozitimit ekzistues në një vend depozitim të kontrolluar dhe të aftë për të përbulluar zgjerimin e mëtejshëm të shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve deri në ndërtimin e Qendrës Rajonale të mbetjeve.

Gjithashtu, sikurse është parashikuar në Planin Kombëtar Territorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta 2019–2032 dhe në Planin Rajonal të Menaxhimit të Mbetjeve për Qarkun Berat, është planifikuar ndërtimi i 2 stacioneve të transferimit të mbetjeve, përkatësisht në Bashkinë Skrapar dhe Bashkinë Poliçan, si dhe ndërtimi i Qendrës Rajonale të Mbetjeve në Bashkinë Dimal, e cila do të shërbejë për të 5 bashkitë e qarkut.

Znj. Hysenbelliu theksoi se propozimi për ndërtimin e Stacionit të Transferimit të Mbetjeve në Bashkinë Skrapar ka ardhur si rezultat i dy faktorëve kryesorë:

- distanca e konsiderueshme e Bashkisë nga Qendra Rajonale e Mbetjeve, rreth 27.5 km;
- numri relativisht i ulët i popullsisë, ç'ka përkthehet në sasi të ulët të mbetjeve.

Ajo sqaroi se në kushte të tilla gjeografike, stacioni i transferimit paraqet avantazhe të dukshme krahasuar me transportin e drejtpërdrejtë të mbetjeve drejt qendrës rajonale, pasi kostot e grumbullimit dhe transportit ditor do të ishin të papërbullueshme.

Duke qenë se Bashkia Skrapar shtrihet kryesisht në terren malor dhe me mundësi të kufizuara për identifikimin e territoreve që plotësojnë kriteret teknike dhe mjedisore, ekspertët kanë vlerësuar se vendi më i përshtatshëm dhe më i aksesueshëm për ndërtimin e stacionit është pasuria nr. 267, me sipërfaqe 388.500 m², ZK 3756, Vërzhezhë, fshati Orizaj, paralel me urën e re.

Më tej u bë e ditur se projekti po zbatohet në kuadër të programit “Menaxhimi i Qëndrueshëm dhe Miqësor me Klimën në Sektorin e Mbetjeve të Ngurta”, financuar nga Qeveria Gjermane dhe zbatuar nga Agjencia Kombëtare e Mbetjeve, si pjesë e fazës së dytë të projektit.

Në zbatim të legjislacionit përkatës, për vijimin e procedurave nevojitet miratimi nga Këshilli Bashkiak i vendndodhjes së stacionit të transferimit. U theksua se zhvillimi i kësaj dëgjese nuk kryhet vetëm si detyrim ligjor, por edhe në funksion të transparencës dhe informimit të komunitetit.

Gjithashtu u sqarua se detyra e bashkisë është grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve deri në stacionin e transferimit, ndërsa transporti nga stacioni deri në Qendrën Rajonale të Mbetjeve do të realizohet nga Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve.

Lidhur me funksionimin e stacionit, Znj. Hysenbelliu shpjegoi se ai përbën një zonë të posaçme ku mbetjet magazinohen përkohësisht nga 1 deri në 3 ditë, me qëllim transferimin në mjete transporti me kapacitet më të madh. Në këtë proces mund të kryhen edhe operacione ndihmëse, si ndarja ose ngjeshja e mbetjeve.

Ajo sqaroi se stacioni do të jetë i rrethuar dhe i monitoruar, për të parandaluar hyrjen e paautorizuar të personave dhe kafshëve. Kamionët e grumbullimit do të regjistrohen në hyrje dhe do të orientohen drejt rampës së shkarkimit, ku mbetjet do të kalojnë drejtpërdrejt në kontejnerë të mbyllur, pa u depozituar në tokë. Kontejnerët janë të papërshkueshëm nga uji dhe qëndrojnë të mbuluar gjatë transportit dhe gjatë kohës kur nuk përdoren.

Pas përfundimit të prezantimit, Kryetari i Bashkisë ftoi banorët e fshatrave Orizaj dhe Munushtir të shprehnin mendimet dhe shqetësimet e tyre lidhur me projektin.

Kryetari i fshatit Munushtir Z. Bari Ymeri shprehu shqetësimin e tij në lidhje me mundësinë që mbetjet të qëndronin për periudha të gjata pa u larguar, duke shpresuar që kjo të mos ndodhte.

Kryetari i Bashkisë sqaroi se nuk do të ketë qëndrime të gjata të mbetjeve, pasi procesi do të funksionojë sipas parametrave teknikë të përcaktuar.

Në vijim, Znj. Sonila Hysenbelliu sqaroi se janë kryer analiza të detajuara nga ekspertët, të cilët në bazë të numrit të banorëve kanë vlerësuar sasinë e mbetjeve të gjeneruara në zonat urbane dhe rurale, si dhe kapacitetin e kontejnerëve që do të përdoren në këtë stacion transferimi.

Banori i fshatit Orizaj Z. Sheme Godja ngriti shqetësimin se zona karakterizohet nga erëra të forta dhe pyeti nëse mund të krijoheshin probleme nga aroma e mbetjeve.

Në përgjigje, Kryetari i Bashkisë sqaroi se mbetjet nuk do të kenë kontakt me mjedisin e jashtëm, pasi do të transferohen drejtpërdrejt nga mjetet e grumbullimit në kontejnerë të mbyllur. Ai theksoi se procesi është i mbyllur dhe nuk parashikon depozitim të mbetjeve në natyrë.

Më pas, fjalën e mori banori i fshatit Orizaj, Z. Jonuz Zylyftari, i cili u shpreh se, nëse procesi do të zhvillohet sipas parametrave të paraqitur gjatë dëgjësës, ai ishte dakord me realizimin e projektit.

Znj. Sonila Hysenbelliu sqaroi se kjo dëgjësë publike zhvillohet vetëm për përcaktimin e vendndodhjes së stacionit të transferimit. Ajo informoi se, përpara pajisjes me leje mjedisore, do të organizohet një dëgjësë e dytë publike nga institucionet përgjegjëse, ku do të paraqitet projekti i detajuar dhe do të jepen shpjegime më të hollësishme mbi zbatimin e tij.

Një pyetje tjetër u ngrit nga banori i qytetit të Çorovodës, Z. Tori Hysi, i cili pyeti nëse do të ketë shtim të mjeteve të transportit.

Kryetari i Bashkisë u përgjigj se parashikohet vënia në funksion e dy mjeteve transporti.

Z. Halim Kapllani banor i fshatit Orizaj ngriti kërkesën që, duke qenë se do të realizohet ky investim, të shqyrtohet mundësia e vendosjes së një pompe uji për vaditje, shërbim i domosdoshëm për komunitetin e zonës.


Në përgjigje, Kryetari i Bashkisë, Z. Adriatik Mema, u shpreh se kjo kërkesë do të merret në konsideratë dhe se bashkia do t'ia përcjellë projektin si kërkesë të komunitetit. Ai kërkoi që banorët të përcaktojnë nevojat konkrete dhe kapacitetin e nevojshëm të pompës, në mënyrë që të shqyrtohet mundësia e realizimit të saj.

Në përfundim, Z. Mema, falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për kontributin, diskutimet dhe sugjerimet e dhëna, duke deklaruar të mbyllur dëgjësën publike.

Mbajti procesverbalin:

Përgjegjëse e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Jusilda **DYRMISHI**



Bashkëngjitur: Lista e pjesëmarrësve në dëgjësën publike dhe fotografi.